

Raporti i v.2010 i Analizave të Përqendruara tek Mendimet e Qytetarëve Kushtet socio-ekonomike dhe Cilësia e Jetës




Faza e dytë e Axfordës sociale të BE-së 2005-2010 nënvizon "punën dhe mundësitë për të gjithë" por gjithashtu bën thirrje për një "Evropë Sociale", që të dyja janë politika të rëndësishme për vendet që janë kandidatë për anëtarësim në BE. Republika e Maqedonisë si një vend kandidat i tillë, dhe si një vend në tranzicion, ende vuan nga shumë probleme të përjashtimit social, që janë përkeqësuar edhe më tepër nga pasojat e krizës ekonomike globale.

Cilësia e jetës është e lidhur ngushtë me kënaqësinë dhe lumturinë e një individi. Njerëzit me një cilësi të lartë të jetës kanë më shumë gjasa t'i kontribuojnë një shoqërie të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Hulumtimet e fundit tregojnë se njerëzit që jetojnë në ekonomitë në tranzicion kanë tendencë që të kenë një cilësi më të ulët të jetës dhe të jenë më pak të lumtur se ata që jetojnë në ekonomitë e zhvilluara të tregut. madje edhe duke marrë parasysh ndryshimet në standardet materiale të jetesës. Kjo është edhe më e theksuar në vendet të cilat kanë përjetuar konflikte etnike dhe konflikte të tjera civile gjatë procesit të tranzicionit.

Analiza në këtë pjesë tregon se nuk ka shumë dallim midis shqiptarëve etnikë dhe maqedonasve etnikë lidhur me çështjen e kënaqësisë dhe lumturisë, që sugjeron se ata përjetojnë probleme të ngjashme ekzistenciale. Treguesit për kënaqësinë dhe lumturinë vendosin pakicat etnike në pozitën më të ulët të mirëqenies subjektive, sidomos popullsinë rome.

Niveli i arsimit është një nga përcaktimet e kënaqësisë në jetë dhe të dhënat e sondazhit tregojnë se vlerat më të ulëta të kënaqësisë në jetë janë të lidhura me nivele të ulëta të arsimit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për lumturinë. Niveli i lumturisë shtohet me nivelin e edukimit. Arsimi i lartë është i lidhur me kushte më të mira ekonomike të amvisërisë (vetëm 12% e atyre me arsim fillor, në krahasim me 26% të atyre me arsim të lartë, janë deklaruar se situata e tyre financiare ishte përmirësuar). Kjo gjetje priret të mbështesë fushatën e tanishme të qeverisë për të ngritur nivelin e arsimit dhe për të nxitur mësimin gjatë gjithë jetës.

Kënaqshmëria me standardin e jetesës (shkalla 1-5)



Varfëria si çështje kruciale gjithashtu është diskutuar në këtë Raport. Ashtu siç pohonte Adam Smith se "asnjë shoqëri nuk mund të lulëzojë dhe të jetë e lumtur kur pjesa më e madhe e anëtarëve janë të varfër dhe të mjerë". Varfëria pengon zhvillimin social, zmadhon shumë probleme sociale përfshirë ato që kanë të bëjnë me shëndetësinë, arsimin, krimin dhe varfshmërinë nga droga. Analiza ka treguar se njerëzit në zonat urbane ballafaqohen me më shumë probleme financiare se sa ata në zonat rurale. Kjo mbase ndodh për shkak të faktit se ka pasur shumë ristrukturime industriale në zonat urbane dhe shumë punëtorë kanë mbetur pa punë, duke çuar në një papunësi të lartë. Ndërkohë, fshati ende paraqet burim të denjë të të ardhurave.

Konceptit të përjashtimit Social i kushtohet një pjesë e spikatur në këtë publikim. Reduktimi i përjashtimit social dhe promovimi i kohezionit social janë objektiva të deklaruara të Bashkimit Evropian dhe, me rreth 16% të qytetarëve të BE-së në rrezik të varfërisë, lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit social paraqet një sfidë të madhe. Republika e Maqedonisë nuk paraqet përjashtim. Programi për mbrojtjen sociale, i paraqitur në v. 2009, është ndikuar nga konventat ndërkombëtare, siç janë Strategjia për kohezionin social, dhe pjesa e parë e Objektivave zhvillimore të Mijëvjeçarit të OKB-së për zvogëlimin e varfërisë. Ky program përfshin masa për zvogëlimin e varfërisë dhe përjashtimit social, si dhe zhvillimin e metodave jointucionale për të garantuar sigurinë sociale për grupet e cenushme.

Siguria e punës është një komponentë e rëndësishme e përfshirjes sociale. Një punë e mirë u jep njerëzve një mundësi për avancim, por vetëm një e katërta e të anketuarve ka pohuar se puna e tyre ofron shanse të mira për avansimin në karrierë. Në këtë drejtim, shqiptarët etnik janë më optimistë se maqedonasit etnik (46% kundrejt 23%).

Republika e Maqedonisë është një nga pak vendet që ka bërë hapa drejt sigurimit të shërbimeve shëndetësore pa pagesë për të gjithë, madje edhe për njerëz pa banim të përhershëm në këtë shtet. Aktualisht, 92% e popullatës mbulohen nga sigurimi social shëndetësor. Megjithatë, krahas mbulimit të gjerë nga sigurimi shëndetësor, gjetjet tregojnë se njerëzit kanë besim më të madh në spitalet private, ku punon shumica e ekspertëve të kualifikuar në fushat përkatëse të mjekësisë, se sa në institucionet shtetërore shëndetësore, edhe pse sektori privat shëndetësor është zhvilluar relativisht kohët e fundit. . Kjo është një dëshmi se duhet të bëhen ndryshime të mëdha në sektorin publik të shëndetësisë, veçanërisht në shërbimin primar mjekësor, nga që shumë njerëz jetojnë në varfëri dhe nuk janë në gjendje të paguajnë për shërbime shëndetësore private.

Në perspektivë: u rekomandohet politikëbërësve që të ndryshojnë fokusin e politikës sociale larg nga dimensionin etnik, që të merren më drejtpërdrejt me problemet reale sociale, që të përmirësohet standardi i jetës, që të shtohet mirëqenia, lumturia e njerëzve dhe kohezioni social në shoqëri e cila synon të jetë pjesë e komunitetit evropian.

Rreth serive të Raportit të Analizave të Përqëndruara tek Mendimet e Qytetarëve: Raporti i v. 2010 i Analizave të Përqëndruara tek Mendimet e Qytetarëve vazhdon të ekzaminojë trendet dhe aspektet e përfshirjes sociale siç është bërë që nga botimi i tij i parë në mars 2008, ku fokusi kryesor i Raportit ishte përfshirja sociale e ekzaminuar përmes thjerrëzave të dimensioneve Qeverisë dhe Etnike. Kjo seri raportesh vazhdoi me botimin e dytë në prill 2009, ku fokusi kryesor vihej tek zhvillimi Rajonal dhe Cilësia e jetës. Secili raport mbështetet tek gjetjet e sondazhit me 1,000 të anketuar (3000 të anketuar për raportin e dytë Rajonal) në gjithë vendin me mbështetje financiare nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Këto raporte synojnë krijimin e hapsirës për hulumtime profesionale, të paanshme, të balancuara, pragmatike dhe konstruktive të politikave dhe të kapaciteteve në vend, me vlerësime mbi rritjen e përfshirjes dhe politikëbërjen e bazuar mbi evidencën, cilësinë e qeversijes dhe përfundimisht mbi jetët e njerëzve.

RRETH KONCEPTIT TË PËRFSHIRJES SOCIALE: Përfshirja sociale përcakton vlerat e një shoqërie me anë të njohjes së "detyrës për t'u kujdesur" të qeverisë për të siguruar të gjitha mjetet e nevojshme për çdo person që të jetë pjesë e shoqërisë moderne me mundësi të barabarta sociale, ekonomike dhe/ose politike. Ajo poashtu adreson të gjitha format e pabarazisë brenda-shtetit. Përfshirja sociale është përgjigje ndaj mangësive institucionale, që është një proces afatgjatë i cili kërkon ndryshime në qëndrimet sociale dhe raportet e pushtetit. Ajo poashtu ka një anim operacional, që planifikon përgjigjet e politikave të realizueshme, duke njohur në mënyrë efektive se Shteti ka 'detyrë për t'u kujdesur' për të përfshirë të gjithë pjesëtarët e shoqërisë në proceset politike, ekonomike dhe sociale. Aq më tepër, përfshirja sociale duhet t'u përgjigjet diskriminimeve të ndryshme si gjinia, moshja, etniciteti ose paaftësia, etj.

RRETH UEJL-së: Universiteti i Evropës Juglindore është institucion i arsimit të lartë në vitin e tetë të veprimtarisë së vetë. Nga hapja e kampusit në Tetovë në tetor 2001, ai ka arritur të ngritet në një universitet të drejtuar nga cilësia dhe financiarisht i qëndrueshëm. Ai shikohet tash si model i arsimit të lartë shumëetnik, shumëgjuhësor në Evropën Juglindore. Ka arritur të bëjë kombinimin e përvojës më të mirë evropiane dhe amerikane dhe ka vazhduar të përfitojë nga bashkëpunimi akademik i sponsorizuar nga Komisioni i BE-së dhe USAID-i, krahas donatorëve të tjerë. UEJL arrin tek institucionet tjera duke promovuar bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve, shkëmbimin e studentëve dhe stafit dhe në komunitetin e tij. www.seeu.edu.mk quality-led, financially sustainable university. It is now regarded as a model for multi-ethnic, multi-lingual higher education in South East Europe. It has succeeded in combining the best of European and US experience, and has continued to benefit from academic collaborations sponsored by the EU Commission and USAID, among other donors. SEEU reaches out to other institutions in promoting research collaboration, exchange of students and staff and its community. www.seeu.edu.mk

